



Kuvendi i Komunës Klinë  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01Nr 06-12753 /22  
Klinë, dt: 27.04 /22

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më  
14.03.2022, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e komitetit, drejtorët dhe gjithë të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Më pas, kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i propozim-listës së pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim nga komuna,
4. Shqyrtimi i Programit komunal tre vjeçar për banim,
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Shkurt-Mars 2022,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës! Pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës.

Me 7 vota PËR u miratua rendi i ditës së bashku me kërkesën e parashtruar për shqyrtim nga drejtoria e shërbimeve publike.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Të gjithë anëtarët e komitetit janë prezent.

## **Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar urdhëroni!

-Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

## **Pika 3. Shqyrtimi i propozim-listës së pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim nga komuna**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Besoj se tashme të gjithë e keni listën e këtyre pronave, unë ju propozoj që ne ta shqyrtojmë këtë listë këtu në komitet, por të presim deri në seancë të sjellët me interpretime ligjore të sakta, sepse kemi dilemë se dy ligje në këtë rast nuk janë të harmonizuara në mes veti, ligji për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës dhe Ligji për shitje në nëse i respektojmë të dyja s'mund të nxjerrim një vendim të saktë. Nëse edhe ju pajtoheni, ne po e rekomandojmë për seancë por nëse nuk kemi ndonjë interpretim të saktë ligjor ne mund edhe ta tërheqim nga rendi i ditës në seancë.

**Znj. Mendehie Duraku:** Faleminderit kryesues, Përshëndetje për të gjithë! Unë e shikova këtë listë dhe mendoj se duhet ti shtohen adresat e sakta kësaj liste se ku gjinden këto prona sa po e shoh vetëm e para e ka adresën ndërsa tjerat jo. Prandaj duhet ti vendoset adresa ku gjenden, që ta kemi me të qartë.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Prandaj po e them se ne duhet trajtuar lënda deri në seancë. Faji nuk është as te ekzekutivi dhe as te legjislativi sa i përket këtij moskuptimi. Por ne deri në seancë do të qartësojmë çdo gjë në mënyrë që mos të bimë në lajthitje as në Kuvend.

**Z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje për ju dhe të gjithë të pranishmit! Mendoj se është një punë shumë e mirë e cila po bëhet, tash është formuar edhe komisioni për evidentimin e pronave komunale, shpresoj se e kanë përfunduar punën edhe ata sepse një kohë të gjatë komuna nuk e ka ditur se ku i ka pronat e veta. Unë pajtohem të shiten këto lokale, vetëm se duhet ta respektojmë ligjin.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë po pajtohem me ty Tunë, E mira e kësaj është se po bëhet evidentimi i tyre por që duhet respektuar procedurat ligjore për dhënien e tyre në shfrytëzim apo shitjen e tyre. Edhe unë pajtohem që të shiten këto lokale, sepse të paktën komuna përfiton të hyra nga tatimi në pronë kjo me e pakta.

**Z. Zafer Gashi:** Faleminderit kryesues! Unë e pash shumë të rëndësishme këtë pikë dhe për këtë arsye erdha. Lista të cilën e pash mendoj se nuk është komplet. Ka qenë mirë që për anëtar të asamblesë ta kemi listën se kush i ka shfrytëzuar deri tash, dhe qka do të bëhet me borxhet e akumuluar sepse unë e kam një listë ku shihet se shumë nga personat që i kanë shfrytëzuar janë akumuluar borxhe. Kjo dukuria e dhënies të dytit dhe të tretit ka ndodhur dhe është e vërtetë. Gjithashtu këtu në këtë listë nuk po i sheh edhe disa prona të cilat janë kërkuar nga qytetaret për dhënie në shfrytëzim, kërkesa të cilat unë i kam parë, apo ndoshta nuk njihet si pronë e komunës.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Njihet si pronë, por nuk hyn në këtë listë. Ne për katër vite me radhë nuk kemi publikuar asnjë listë të pronave të cilat mendohen të jepen në shfrytëzim prandaj dhe nuk kemi dhënë prona në shfrytëzim. Pra nëse nuk bëhet kjo listë deri me 31 mars këtë vit nuk mund ti japim askujt asnjë pëllëmbë.

**-Pas debatit rreth kësaj pike, kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend propozim-listën e pronave komunale.**

#### **Pika 4. Shqyrtimi i Programit komunal tre vjeçar për banim**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Ky program trajton vetëm banimin social, ne tashme i kemi tri apo katër objekte të banimit social. Nëse shiten lokalet të cilat ishin në listën e pronave komunale të cilën e trajtuam, këto mjete do të dedikohen për realizimin e projektit për banim social. Unë po hapi debat!

**Z. Mendehie Duraku:** Faleminderit kryesues. Unë thjesht e kam lexuar këtë program për banim, vetëm dëshiroj ta dijë aty tek historiku i Klinës për disa të dhëna që ishin aty, a është e vërtet se çdo banor i Klinës merr 252 euro për kok banori të ardhura. Thjesht ma mori mendja se kjo nuk është e vërtet, nuk e di unë kah e kanë marr këtë dhe e kanë qitë.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Seancën e ardhshme do ta pyesim drejtorin, me siguri ai do t'na sqaroj.

**Z. Tunë Dedaj:** Kryesues, mendoj se ka qen mirë që banesat të cilat janë duke u shfrytëzuar nga banues social dhe të cilat janë të lëshuara me qira nga komuna të verifikohen kushtet e tyre dhe ata të cilët kanë dy apo tre persona në punë t'i lirojnë banesën diku që ka nevojë për banim.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Ne edhe njëherë e kemi debatuar këtë çështje në kuvend dhe është kërkuar të bëhet lista e saktë e të gjithë atyre banuesve. Sepse ka raste se e shfrytëzon pala e dytë apo e tretë. Atyre në kontratë ju shkruan se çdo dy vite ju bëhet vlerësimi i gjendjes ekonomike të familjes. Prandaj kërkoj edhe ne që as mos t'i hymë në hak askujt dhe as mos ta shfrytëzon askush pa nevojë.

**Pas përfundimit të debatit rreth programit tre vjeçar për banim, kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR u rekomandua për shqyrtim në kuvend për vënje në diskutim publik.**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Shkurt-Mars 2022**

**Kryesuesi prezantoi me radhë kërkesat:**

##### **Kërkesa 1.**

Kërkesë e parashtruar nga drejtori i SHFMU "Emin Duraku" Sferk për Komitetin për Politik dhe Financa dhe kryesuesin e Kuvendit komunal z. Fadil Gashi, që të mundësoj bartjen e nxënësve vajtë-je dhe ardhje në shkollë, pasi që largësia është mbi 4 km nga shkolla.

-Pasi të gjithë anëtarët njëzëri u pajtuan që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorin e Arsimit.

**Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa rekomandoj që kërkesa të kaloj për shqyrtim në Drejtorin e Arsimit, pasi që kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe i takon Drejtorisë së Arsimit.**

#### **Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga mësimdhënësit të cilën kanë qenë kandidat në zgjedhjet e vitit 2021, ku kërkojnë që me anë të një vendimi t'u mundësohet kompensimi i ndalesës në pagë që ju është ber në tetorin e vitin 2021.

Lista e mësimdhënësve: Rasim Millaku, Lirije Zogaj, Eneda Behramaj, Hamdi Rraci, Xhevdet Kadrija, Nezir Racaj, Naim Berisha, Loreta Tanushi, Alber Haxhaj, Kushtrim Haliti, Demë doqi.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** mendoj se nuk ka te bej kjo kërkesë me vullnetin tonë, pasi qe ligji e përcakton ndalesën në pagë. Unë po hapi debat, sa i pakët kësaj kërkesë!

**Z.Tunë dedaj:** Me gjithë respektin qe kam për ata, ata e kanë ditur qe në fillim se momentin qe kandidojn për asamble paga do ti ndalohet pe rate periudhë kohore sa nuk e zhvillon procesin mësimor. Unë jam qe të zbatohet ligji ashtu siç parashihet.

**Z. Bledar Berisha:** Përshëndetje për të gjithë, ashtu siç e tha edhe z. Tuna, ata e kanë ditur këtë çështje sepse është e rregulluar edhe me ligj prandaj nuk mundemi ne si komitet ti propozojmë kuvendit të nxjerr një vendim i cili është i jashtëligjshëm.

**-Pas përfundimit të debatit, Kryesuesi z. Gashi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa në fjalë të shqyrtohet nga Drejtoria e Arsimit në Klinë.**

#### **Kërkesa 3.**

Kërkesë e parashtruar nga Leka Dedaj për marrje në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pronën komunale, ku thekson: Unë pronar i lokaleve, sipas lejeve të ndërtimit: 07-Nr. 351-60/2004 të datës 25.04.2004 e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Shërbime Publike të ndërtuara në një pjesë të parcelës private me nr. 0054-0 ZK Klinë dhe një pjesë të parcelës pronë shoqërore me nr. 00537-5 ZK Klinë. Kërkoj që parcela me nr. 00537-5 të me jepet në shfrytëzim.

Gjithashtu kërkon që ti jepet në shfrytëzim edhe prona komunale me nr. 00537-3 të cilën aktualisht e shfrytëzon për teras të kafiterisë Coyota.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne edhe me herët biseduam për çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronave shoqërore, mendoj se edhe kjo kërkesë siç i kemi trajtuar të gjitha kërkesat e kësaj natyre, të dërgohet për shqyrtim në drejtorit përkatëse ashtu siç e përcakton ligji të kryhen procedurat e parapara mandej të vije në kuvend. Unë po hapi debat!

-Pasi askush nuk mori fjalën kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që edhe kjo kërkesë të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit duke kërkuar nga drejtorit përkatëse si drejtoria për Kadastër, Gjeodezisë dhe Pronësisë dhe drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta kompletojnë ligjërisht si lënd duke respektuar Ligjin Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për

**përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vije në Kuvend.**

#### **Kërkesa 4.**

Kërkesë nga Grupi Parlamentar i LVV-së për fillimin e procedurave për ndryshim të rregullores 01-Nr.05-8132 të miratuar me datë 04.03.2020, rregullore për ndarjen e bursave për student të Komunës së Klinës. Me propozimet konkrete:

1. Të rritet numri i studenteve bursist nga 40 në 60 student, me nga 50 euro në muaj.
2. Të fillohet me bursa solidare për 50 nxënës të shkollës së mesme me bursë nga 25 euro, bazuar në kriteret përzgjedhëse të komisionit të emëruar nga ne në asamble.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Pasi se qenka e doktori këtu po e theksoj se nuk kemi nevojë për këtë çështje të fillojmë me procedura për ndryshim të rregullores për ndarjen e bursave, pasi që Ne çdo vit marrim vendim në kuvend, ku përcaktohet numri i përfituesve të bursistëve dhe shuma sepse rregullorja e përcakton kështu. Prandaj kërkoj mirëkuptimin tuaj.

**Z. Zafer Gashi:** Faleminderit, po ne kemi kërkuar pikërisht të ndërhyhet në rregullore për këtë çështje, sepse jemi bazuar në fjalët e kryetarit se duhet ndryshohet rregullorja për rritjen e numrit për përfituesit e bursave prandaj kemi insistuar që të kemi votat e shumicës për ndryshimin e rregullores.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Edhe unë e kam pasur dilemën e njëjtë, por pas leximit të rregullores e ka hedhur poshtë mendimin tim por edhe të kryetarit. Sepse në rregullore përcaktohet qartë se numri dhe shuma e ndarjes përcaktohet me vendim të Kuvendit.

**Znj. Valmire Krasniqi:** Atëherë po e lemë ashtu me vendim të kuvendit.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Unë po pajtohem me zonjushën, nëse edhe ju pajtohem nuk po hymë në procedura të ndryshimit të rregullores qasi që janë të parapara me vendim të kuvendit të përcaktohen ato të cilat u kërkuan.

**-Pas Debatit kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, vendosi që kërkesa të mos kalojë tutje, për arsyeje se me rregulloren aktuale, kuvendi merr vendim çdo vit për numër të studenteve të cilët do të përfitojnë dhe shumen të cilën do ta përfitojnë.**

#### **Kërkesa 5.**

Kërkesë e parashtruar nga Skender Skeli, Nol Skeli, Robert Skeli dhe Lon Skeli, me vendbanim në rrugën Ramë Sadiku Klinë, ku theksohet se si pronar të lokalit të ndërtuar me material të fortë në vitin 1983, lokali me numër 146 e ndërtuar në parcelën Nr. 9004-0 ZK Klinë, tani sipas shënimeve të kadastrit P- 71006024-00527-1ZK Klinë, sipërfaqja 80m<sup>2</sup> sipas vendimit të Komunës së Klinës nr. 04-313-138 të datës 16.05.1983 me destinacion për të punuar si mishtore ku ende funksionon, kërkohet se pas shpalljes së ankandit publik ti jepet për shfrytëzim afatgjatë për 99 vite.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Nëse edhe ju pajtoheni edhe kjo kërkesë të trajtohet ashtu siç i kemi trajtuar kërkesat e kësaj natyre, të respektohet ligji për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Unë po hapi debat!

Pasi askush nuk mori fjalën, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa rekomandoj që kjo kërkesë të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe në drejtorin për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronësisë të kompletohet si lënd duke respektuar Ligjin Nr.06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vijë në Kuvend.

#### **Kërkesat 6,**

Kërkesë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së për mbështetje financiare, të cilët theksojnë se shpenzimet e përgjithshme lidhur me aktivitetet të cilat i zhvillojnë, si homazhet në varrezat e dëshmorëve, punimi i karteleve, vërtetime, takime zyrtare në Prishtinë, vendosja e pllakave neper shtëpi të cilat kanë shërbyer për UÇK-në, takime jashtë vendit si Kroaci, Shqipëri etj, kërkesa për banjë për rehabilitimin e veteranëve me probleme shëndetësore dhe ekonomike. Kostoja gjatë gjithë vitit 2022 është **5500 euro**.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Unë po them se ne duhet ta mbështesim, ta dërgojmë në zyrën e kryetarit paraprakisht, me pa se a mund të ndihmohet nga subvencionet, sepse nëse trajtohen si OJQ këta duhet të ndihmohen përmes shpalljes publike pra duhet të aplikojnë aty, por nëse nuk ka ndonjë mënyrë tjetër që ti ndihmoj mund ta sjell prap kryetari në kuvend.

Pra ta keni parasysh kemi tri kërkesa të natyrës së njëjtë:

**Kërkesa nga Organizata e veteraneve të Luftës së UÇK-së shuma 5500 euro**

**Kërkesë nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së shuma 3450 euro.**

**Kërkesë nga Shoqata e Familjeve të Dëshmoreve shuma 3500 euro.**

Unë po hapi debat!

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Unë kam një kërkesë për kryetarin që seancën tjetër t 'na sjell një listë se sa herë i ka ndihmuar për katër vitet e fundit të gjitha shoqatat, dhe t 'na informoj me gjerësisht. Për ndryshe unë jam që ti ndihmohet shoqatës së OVL-së dhe shoqatat tjera.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne jemi në dilemë, dhe për këtë arsye po e rekomandojmë në zyre të kryetarit. Nëse këto shoqata llogariten si OJQ që duhet të aplikojnë në thirrje publike për përfitim andaj s'po mundemi ta rekomandojmë për kuvend sepse mund ta qesim në lajthitje kuvendin. Vitin e kaluar kemi marr vendim në kuvend për ndarje të mjeteve për këto kategori, por ka ndryshuar ligji dhe se di si janë te regjistruara këto dhe si do të trajtohen.

-Pas përfundimit të debatit kryesuesi hodhi në votim Tri kërkesat e parashtruara nga Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së dhe me 7-të vota PËR Komiteti për Politik dhe Financa rekomandoj që kërkesat e parashtruar nga Organizata e veteraneve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Familjeve të Dëshmoreve, të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit me propozimin që ti ndihmohet sipas mundësive buxhetore.

**Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kërkesave:**

#### **Kërkesa7.**

Kërkesë e parashtruar nga Samije Gjergjaj, për ndihmë financiare, e cila thekson se gjendja shëndetësore e sajë nuk është e mirë dhe kërkohet trajtim urgjent. Pas konstatimit të CT në janar të këtij viti 2022 ku rezultoi një tumor në mëlçi dhe pjesë të tjera. Po ashtu thekson se vuan nga kjo sëmundje nga viti 2004 dhe se kostoja për trajtimin e sëmundjes është e pa përballueshme.

Të gjithë, anëtarët e KPF-së njëzëri u pajtuan që kërkesa të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit që t'i ndihmohet nga subvencionet pa rekomanduar ndonjë shumë.

**-Kryesuesi hodhi në votim dhe 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga znj.Samiye Gjergjaj për ndihmë financiare të kaloj për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe ti ndihmohet sipas mundësive buxhetore.**

#### **Kërkesa 8.**

Kërkesë e parashtruar nga Partia Rome e Bashkuar, për propozimin e anëtarit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi nga radhët e komunitetit Rom, të cilët i propozojnë Kuvendit që anëtar i KKSBB-së të jetë Ramadan Gashi nga fshati Dollov.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Nëse ju pajtoheni, këtë kërkesë po e adresojmë në zyrë të kryetarit për shqyrtim, pasi që sipas udhëzimit për themelimin e këshillit të sigurisë në bashkësi, propozim listën për anëtarët e KKSBB-së e formon kryetari pastaj vjen në Kuvend për votim.

**-Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7-të vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa rekomandoj që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit.**

#### **Pika 6. Të ndryshme**

Pasi, askush nuk kishte diçka tjetër për të shtuar, kryesuesi, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë, me kaq po e mbylli mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësi,

Ahmet Berisha



Kryesuesi,  
Fadil Gashi